

PROFETI I FUNDIT

PAQJA DHE BEKIMI I ALLAHUT QOFSHIN MBI TË



Islamhouse

Titulli

Profeti i fundit

Titulli në origjinal

Hatem en-nebijjin, sal-lallahu alejhi ue sel-lem

Autor

Zyra e Bashkëpunimit për Davet dhe Vetëdijesim të
Komuniteteve – Rabve

Përkthyes

Almedin Ejupi

Redaktor gjuhësor

Jeton Koqinaj

Redaktor fetar

Jusuf Kastrati

I Dërguari ﷺ¹ thoshte: *“Ai që thërret në udhëzim, do të ketë shpërblimet e atyre që e pasojnë atë, por pa iu pakësuar aspak shpërblimet e tyre.”*²

¹ Sal-lallahu alejhi ue sel-lem (shqip: paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

² Shënon Muslimi.

Parathënie

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin, vulën e lajmëtarëve dhe të dërguarve, prijësin e të devotshmëve, më të zgjedhurin e të gjitha krijesave, si dhe për familjen e shokët e tij dhe për të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

E kam lexuar trajtesën me titull “Profeti i fundit”, botuar nga Zyra Ndihmëse për Thirrje dhe Udhëzim në Rabue, gjë që e konsideroj si diç tejet të dobishme në këtë fushë. Nga kjo trajtesë do të mund të përfitojnë të gjithë muslimanët kundruall sulmeve të ashpra të armiqve të Islamit ndaj

personalitetit të Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!

Këshilloj që ky punim të publikohet e të shpërndahet, me shpresë se Allahu do të sjellë dobi përmes tij.

E lus Allahun ta shpërblejë autorin, sikur që e lus të na dhurojë neve dhe atij sinqeritet në fjalë e vepra, të na bëjë thirrës e mbështetës të së vërtetës, mbrojtës të ligjit të Allahut, ruajtës të fesë e të Dërguarit të Tij, të na udhëzojë në udhëzimin e tij, të na bëjë praktikues të Kuranit e traditës së Pejgamberit të Tij, si dhe të na përforcojë në fenë e vërtetë e në rrugën e drejtë, se me të vërtetë Ai është Bujari dhe Fisniku! Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, krijesën më të zgjedhur, profetin tonë Muhamed, për familjen, shokët dhe për të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit!

Abdulaziz ibn Abdullah er-Raxhihiu

Dëshmia se Muhamedi ﷺ është i dërguari i Allahut

Dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut nënkupton vërtetimin me gjuhë dhe besimin me zemër se Muhamedi, i biri i Abdullahut, kurejsh hashimit, është i Dërguari i Allahut, dërguar te të gjitha krijesat, njerëz e xhinë. Allahu i Lartësuar në shpalljen e Tij të fundit, në Kuran, thotë: **“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Edh-Dhariat, 56)

Adhurimi mund t’i kushtohet Allahut vetëm përmes rrugës së shpalljes me të cilën është dërguar Muhamedi ﷺ, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin (Kuranin) robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.”** (El-Furkan, 1)

Ç'nënkupton dëshmia *Muhamedi është i Dërguari i Allahut?*

Dëshmia se Muhamedi ﷺ është i Dërguari i Allahut, nënkupton të besuarit në atë që ai na ka lajmëruar, zbatimin e asaj që na ka urdhëruar, largimin nga ajo që ai ka ndaluar e paralajmëruar, si dhe adhurimin e Allahut vetëm në përputhje me atë që ai ka ligjësuar. Kjo dëshmi, gjithashtu, nënkupton të mos besosh se i Dërguari i Allahut ﷺ ka ndonjë të drejtë pjesëmarrjeje në adhurim apo ndonjë ndikim në drejtimin e gjithësisë. Ai është thjesht një rob që nuk adhurohet. Ai është i dërguar që nuk mund të përgënjeshtrohet dhe nuk posedon kompetencë as për veten e as për të tjerët t'u sjellë ndonjë dëm ose dobi, përveç nëse do Allahu, ashtu siç thotë Ai lidhur me të: **“Thuaj: “Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam melek. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet.” Thuaj: “A barazohet i verbri me atë që sheh? A s’po mendoni?”** (El-Enam, 50)

Ai është rob që urdhërohet dhe zbaton atë që i është urdhëruar. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu. Sikur ta dija të padukshmen, do t’i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira për njerëzit që besojnë.”** (El-Araf, 188)

Duke u mbështetur në këtë, mësojmë se megjithatë adhurimin nuk e meriton as i Dërguari i Zotit ﷺ, aq më pak ndonjë krijesë tjetër. Adhurimi i takon vetëm Allahut të Lartësuar dhe askujt tjetër. E drejta e Muhamedit ﷺ është t’ia njohim pozitën që Allahu i Lartësuar ia ka dhënë dhe caktuar. Ai është rob i Allahut dhe i dërguar i Tij, *paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!*

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe Profeti i fundit; Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.” (El-Ahzab, 40)

Dijetari i nderuar es-Sadi, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: “Kjo është shkalla e tij, i cili i bindet Allahut dhe pasohet, përmes tij Allahu i Lartësuar udhëzon në rrugën e drejtë. Ai i cili e beson atë për të dërguar, obligohet t’i japë përparësi dashurisë ndaj tij kundrejt dashurisë së çdokujt tjetër. Ai është këshillues i tyre, respektivisht këshillues i besimtarëve, që u bën mirë dhe që i këshillon sikur të jetë babai i tyre.”³

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcjell se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Unë dhe të dërguarit e tjerë i shëmbëllemë njeriut i cili ka ndërtuar një shtëpi, që e ka mbaruar dhe stolitur mirë, porse një tullë e ka lënë të pavënë në një qoshe. Sa herë që njerëzit e vizitonin shtëpinë, thoshin të mrekulluar: “Ah, sikur ta vinte edhe këtë tullë.” Kështu, në raport me profetët, unë gëzoj vendin e tullës në fjalë.”⁴

³ *Tejsirul kerimil menani fi tefsiri kelami Rrahmani.*

⁴ Shënon Buhariu.

Emrat e tij ﷺ

I Dërguari ﷺ ka thënë: *“Unë i kam pesë emra: Unë jam Muhamedi dhe Ahmedi, unë jam Fshirësi (el Mahi): nëpërmjet meje Allahu do ta fshijë kufrin (mosbesimin), unë jam Tubuesi (el Hashir): njerëzit do të tubohen te këmbët e mia, dhe unë jam Përmbyllësi (el Akib), që s’do të ketë asnjë profet pas meje.”* (Shënon Buhariu, pa fjalinë e fundit pas presjes, të cilën e shënon Muslimi)

Profeti i fundit ﷺ

Pejgamberi Muhamed ﷺ ka thënë: *“Në umetin tim (pas meje) do të ketë tridhjetë gënjeshtarë pretendues se janë profetë, porse unë jam i fundit nga të gjithë profetët, s’ka të dërguar pas meje. Në umetin tim, në vazhdimësi, do të jetë një grup i ndihmuar, që pason të vërtetën dhe nuk dëmtohet*

nga ata që e kundërshtojnë, derisa të vijë gjykimi i Allahut.”⁵

Unë jam Pejgamberi pa asnjë gënjeshtër

I Dërguari ﷺ ka thënë: *“Unë jam Pejgamberi pa asnjë gënjeshtër, jam pasardhës i Abdulmutalibit.”⁶*

Dijetari i shquar, Ibn Haxheri, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Në thënien e tij ‘pa asnjë gënjeshtër’ sinjalizon se gënjeshtërja është e pamundur të bashkëjetojë me Pejgamberin. Ai sikur ka dashur të thotë: “Unë jam pejgamber, gjë që Pejgamberi nuk gënjen. Unë nuk jam gënjeshtar në atë që them, edhe nëse mposhem. Unë jam i bindur se fitorja që më premtoi Allahu është e vërtetë, ndaj nuk më lejohet të ik.” Gjithashtu, domethënia e pjesës ‘pa gënjeshtër’, është: “Unë me të vërtetë jam profet, gjë që nuk është e gënjeshtërt.”⁷

⁵ Shënon Ahmedi.

⁶ Shënon Buhariu.

⁷ *Fet’hul Bari sherhu Sahihil Buhari.*

Dijetari Nevevi, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Domethënia e fjalës së të Dërguarit ﷺ ‘Unë jam Pejgamber pa asnjë gënjeshtër’ është: ‘Unë jam profet i vërtetë, as nuk iki, as nuk zhdukem.”⁸

Unë jam i Dërguari pa asnjë gënjeshtër, respektivisht, unë nuk gënjej në atë që them. Mund të mposhem në betejë, por i mposhtur është ai që nuk është i bindur në fitore dhe që i frikësohet vdekjes. Profeti ﷺ ka qenë i bindur thellë në fitoren që ia ka shpallur Allahu i Lartësuar në Librin e Tij (Kuranin fisnik), duke ia bërë me dije se kjo është çështje që do të përmbushet.”⁹

⁸ *Sherhu Sahih Muslim*, En Neveviu.

⁹ *Sherhu Sahihil Buhari*, Ibn Betali.

Ndiqe Profetin e mos fut risi në fe

Sehl ibn Sadi tregon se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Unë do t’ju prij drejt Haudit (pellgut me ujë). Ai që më ndjek, pi, ndërkohë, kush pi në të, kurrë më nuk ndien etje. Te Haudi do të më vijnë disa njerëz, që i njoh e më njohin, por më pamundësohet kontakti me ta (afrimi i tyre te burimi). Do t’u them (melekëve): “Lejojini, se ata janë të umetit tim!” Melekët do të më përgjigjen: “O Muhamed! Ti nuk e di çfarë kanë sajuar pas teje.” Atëherë do t’u them (atyre): “Larg që këtej ata të cilët kanë ndryshuar pas meje (vdekjes sime).”*

Imam Neveviu thotë: “Për thënien e Pejgamberit ﷺ: *“... ndërkohë, kush pi në të, kurrë më nuk ndien etje.”* është thënë se në këtë pellg do të pijë vetëm ai që është caktuar të shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit.”¹⁰

Ndërkaq, dijetari Ibn Uthejmin, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Te ky burim do të venë ata

¹⁰ *Sahihu Muslim.*

që besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, që e pasojnë ligjin e tij. E, ai që heq dorë dhe tregohet kryeneç nga ndjekja e ligjit të Zotit, do të dëbohet nga ky burim.” (Sherhul akidetil uasitije).

Mëshirë për botët

Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** (El Enbija, 107)

Ibn Kethiri, *Allahu e mëshiroftë*, në komentin e këtij ajeti kuranor, thotë: “Allahu i Lartësuar njofton se Muhamedin ﷺ e ka bërë mëshirë për botët, përkatësisht, ua ka dërguar nga mëshira. Ai që e pranon këtë mëshirë dhe është falënderues për këtë begati, do të jetë i lumtur në këtë jetë dhe në të përtejmen, ndërkaq, ai që e refuzon, do të jetë i humbur në të dy botët.”

Pejgamberi ﷺ thoshte: “Unë jam mëshirë e dhuruar.”¹¹

Modele nga mëshira e tij ﷺ

Njëherë, kur e pat përgënjeshtuar populli i tij, i pat vajtur Xhibrili duke i thënë: “Allahu dëgjoi ç’të tha populli yt dhe pa si t’u përgjigjën, kështu që Ai ta çoi melekun e maleve, të cilin mund ta urdhërosh t’u bëjë atyre njerëzve ç’të duash ti. *Meleku i maleve më thirri, më përshëndeti dhe më tha: “O Muhamed! Më urdhëro ç’të duash! Po deshe ti, unë i bashkoj të dy malet (e luginës) dhe ua hedh përsipër. Mirëpo, i Dërguari ﷺ i tha: “Jo, se shpresoj që Allahu do të nxjerrë prej tyre pasardhës që do të adhurojnë Allahun Një, të Vetmin, duke mos i vënë Atij shokë në adhurim, duke mos adhuruar askënd përveç Tij.”*¹²

¹¹ Shënojnë Darimiu dhe Darakutniu, ndërsa Albani e klasifikon sahih në librin *Mishkatul mesabih*.

¹² Shënon Buhariu.

Mëshira e tij ndaj armiqve

Tufejl ibn Amër ed-Deusiu kishte humbur shpresën se do të udhëzohej fisi i tij Deus. Ai dhe shokët e tij kishin vajtur tek i Dërguari, me ç’rast i kishin thënë: “O i Dërguari i Allahut, fisi Deus nuk u bind dhe nuk pranoi të të pasojë ty, prandaj lute Allahun kundër tyre.” Profeti, *sal-lalahu alejhi ue selem*, u kthye nga kibla dhe i ngriti duart. Njerëzit (që e shihnin) ishin të bindur se tashmë fisi Deus u shkatërrua, ngase (ata menduan se) i Dërguari i Allahut ﷺ po lutej kundër tyre, mirëpo Profeti i mëshirës tha: “*O Allah! Udhëzoje fisin Deus dhe le ta përqafojë Islamin!*”¹³

Mëshira e tij ndaj kafshëve

I Dërguari i Allahut ﷺ kishte hyrë në kopshtin e një ensariu, ku kishte hasur një deve. Deveja, me ta

¹³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

parë Pejgamberin ﷺ filloi të rënkojë dhe të nxjerrë lot. Profeti ﷺ iu afrua dhe e ledhatoi në qafë, kështu që ajo u qetësua. I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *“Kush është pronari i kësaj deveje? E kujt është? Aty erdhi një djalosh ensar dhe tha: “Imja, o i Dërguari i Allahut.” Atëherë Pejgamberi ﷺ i tha: “A nuk i frikësohesh Allahut kundrejt kësaj kafshe, të cilën Allahu ta ka lënë nën sundim? Ajo m’u ankua që ti po e lë pa ngrënë dhe e lodh me barra të rënda.”*¹⁴

¹⁴ Shënon Ebu Davudi, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

Mëshira e tij ndaj fëmijëve

I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu më i mëshirshëm ndaj fëmijëve. Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi ﷺ e kishte puthur Hasanin, të birin e Aliut, kur tek ai ishte Akra ibn Habis et-Temimi, me ç’rast u çudit dhe tha: “Unë kam dhjetë fëmijë, por s’e kam puthur asnjërin prej tyre.” I Dërguari i Allahut e shikoi dhe tha: “*Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet (nga Allahu).*”¹⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ e kishte vizituar një djalosh të sëmurë hebre, që i shërbente. Ai i tha: “Thuaj: *La ilahe il-lallah*. Djaloshi shikoi babanë e vet, që i tha: “Dëgjoje Ebul-Kasimin.” Kështu, djaloshi e shqiptoi dëshminë, me ç’rast Pejgamberi ﷺ tha: “*Falënderimi i takon Allahut, që e shpëtoi nga zjarri i Xhehenemit.*”¹⁶

¹⁵ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

¹⁶ Shënon Buhariu.

Mëshira e tij ndaj shërbëtorëve dhe robërve

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thotë: ““I kam shërbyer Pejgamberit ﷺ dhjetë vjet, por kurrë nuk më ka thënë "of", as: "Pse e bërë këtë?" e as: "Sikur ta kishe bërë?!""¹⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ e pyeste shërbëtorin: “A ke ndonjë nevojë?”¹⁸

Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi i Allahut asnjëherë nuk ka goditur askënd me dorë, përfshirë robin e gruan, përveçse në luftë në rrugë të Allahut.”¹⁹

Ai ka thënë: “Vërtet, unë jam dërguar mëshirë.”²⁰

¹⁷ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

¹⁸ Shënon Ahmedi, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

¹⁹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

²⁰ Shënon Muslimi.

Sjellja e tij me familjen

Pejgamberi sillej mirë me familjen e vet. Ka qenë i dhembshur dhe i butë me ta. Ua shprehte dashurinë, ishte i kujdesshëm ndaj familjes, madje edhe bënte shaka e luante me ta. Ai ﷺ me bashkëshorten e tij Aishen, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, fliste ëmbël dhe e thërriste me emrat që ajo i donte më së shumti: *“Aishëz dhe Humejra!”* Ai edhe e nderonte duke e thirrur në titullin e babait të saj: *“Oj e bija e Sidikut!”* Krejt kjo në shenjë dashurie, afërsie e dhembshurie ndaj saj, si dhe në shenjë respekti e vlerësimi ndaj familjes së saj. Kur ajo pinte në ndonjë enë, e merrte enën dhe pinte pikërisht në vendin që kishte pirë ajo.

I Dërguari i Allahut ﷺ i ndihmonte familjes në punët edhe nevojat e tyre. Kështu, Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, lahej bashkë me të Dërguarin në të njëjtën enë. Ai i thoshte asaj: *“Ma*

lër mua (ujin), kurse ajo i thoshte: “Jo, ti lërma mua.”²¹

Për më tepër, ai ﷺ i vinte gjunjët e tij, në atë mënyrë që e shoqja, Safija, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, të vinte këmbët për të hipur në deve.”²²

Sjellja e tij me fëmijët dhe të rinjtë

Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi ﷺ kalonte pranë fëmijëve dhe u jepte selam.”²³

Gjithashtu, kur Profeti dëgjonte të qarët e fëmijës, shpejtonte në namaz nga frika se mos shqetësohej e ëma.

Po ashtu, ai ﷺ e mbante mbesën e vet, Umamen, të bijën e Zejnebes, *Allahu qoftë i kënaqur me ta!*,

²¹ Shënon Muslimi.

²² Shënon Buhariu.

²³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

teksa u printe njerëzve në namaz. Kur çohej, e mbante, e, kur binte në sexhde, e lëshonte.

Madje, ai zbriste nga minberi, në mënyrë që t'i merrte nipat e tij, Hasanin dhe Husejnin, *Allahu qoftë i kënaqur me të dytë!*

Të qeshurit e tij ﷺ

Ai ﷺ qeshte e buzëqeshte me familjen dhe shokët e tij. Bënte shaka e shoqërohej me bashkëshortet, bisedonte me to me dashuri, maturi e ëmbëlsi. E ngrinte fytyrën e tij të pastër me buzëqeshjen që rrezatonte dhe, kur takohej me njerëz, fuste gëzim në zemrat e tyre dhe ua përfitonte shpirtrat. Bënte edhe shaka, por thoshte vetëm të vërtetën. Hokat e tij në zemrat e sahabëve ishin më të buta sesa dora e prindit të kujdesshëm kur lëmon kokën e fëmijës. Bënte shaka me ta duke ua gjallëruar shpirtrat, duke ua zgjeruar gjokset dhe duke futur gëzim e hare në fytyrat e tyre.

Xherir ibn Abdullah el Bexheliu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Sa herë që më ka takuar i Dërguari i Allahut, më ka buzëqeshur.” I Dërguari ﷺ i përmbahej mesatares në të qeshurit, shakatë dhe lojën e tij. Mbante mesataren ndërmjet fytyrëvrenjturit dhe atij me qeshje të tepruar.

Modestia e tij ﷺ

Ai ﷺ ishte zotëria i modestëve, gjë që pasqyrohet në thënien e Allahut të Lartësuar: **“Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.”** (El-Kasas, 83)

Pejgamberi i përgjigjej ftesës së robit e të lirit, ftesës së të pasurit e të varfrit. I vizitonte të sëmurët në periferi të qytetit dhe pranonte ndjesën e të përligjshmit. Tregohej modest me besimtarët. Shoqërohej me të moshuarin, vizitonte të sëmurin, tregohej i dhembshur ndaj të varfrit, mbante lidhjet

me të gjerët, i mbështeste të pafuqishmit, luante me fëmijët, bënte shaka me familjen e i fliste robëreshës, hante ushqim me njerëzit e ulej dhe flinte në tokë. Shtronte rërë dhe ulej mbi rrogos. Kur një burrë e kishte parë atë, zuri të dridhej nga autoriteti dhe pozita e tij, por Pejgamberi ﷺ i tha: “Qetësohu, se unë nuk jam mbret. Unë jam thjesht i biri i një gruaje që ha pastërma.”²⁴

Pejgamberi ﷺ nuk e pëlqente lavdërimin, madje ndalonte nga lavdërimi i tepërt i tij, thoshte: *“Mos e teproni duke më lavdëruar siç e lavdërojnë të krishterët Isain, të birin e Merjemes. Unë jam rob dhe i dërguar i Allahut, andaj thoni: Robi dhe i Dërguari i Allahut.”*²⁵

Ishte njeriu më larg mendjemadhësisë, e, si të mos jetë i tillë, kur ai ﷺ ka thënë: *“Mos e teproni duke më lavdëruar siç e lavdërojnë të krishterët Isain, të birin e Merjemes. Unë jam rob dhe i dërguar i*

²⁴ Shënon Ibn Maxhe.

²⁵ Shënon Buhariu.

Allahut, andaj thoni: Robi dhe i Dërguari i Allahut."²⁶

E si të mos jetë i tillë kur thoshte: *"Unë ha, siç ha robi, dhe ulem, siç ulet robi."*²⁷

Si jo, kur ai thoshte: *"Nëse më dhurojnë edhe kockat e këmbëve të deles, unë do ta pranoj dhuratën, madje, nëse më ftojnë të ha edhe kockat e këmbëve të dhenve, unë do ta pranoj ftesën."*²⁸

Shenjë që dëshmon modestinë e tij është se ai i përgjigjej ftesës edhe nëse ftohej për bukë elbi, si dhe e pranonte dhuratën. Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: *"Pejgamberi ﷺ i përgjigjej ftesës edhe kur ftohej për bukë elbi."*²⁹

²⁶ Shënon Buhariu.

²⁷ Shënon Ebu Jala, ndërsa Albani e klasifikon hasen.

²⁸ Shënon Tirmidhiu, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

²⁹ Shënon Tirmidhiu në *Esh Shemail*.

Universaliteti i mesazhit të zotërisë së krijesave ﷺ

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Betohem në Atë i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit se çdo njeri i këtij umeti, qoftë ai hebre a i krishterë, që dëgjon për mua dhe vdes pa i besuar mesazhit me të cilin jam dërguar, do të jetë banor i Zjarrit.”*³⁰

Imam Albani, në “Vargun e saktë të haditheve” 1/241, thotë: “Ky tekst (hadith) është i qartë se ai që dëgjon për Pejgamberin ﷺ e për atë me të cilën është dërguar dhe se tërë kjo i është prezantuar në formën që Allahu ia ka zbritur, porse nuk beson në të, përfundimin do ta ketë në zjarr të Xhehenemit, kjo përfshin të gjithë, pa përjashtim, hebreun, të krishterin, zjarrputistin e ateistin. Bindja ime është se shumicës së jobesimtarëve sikur t’u jepej rasti të njiheshin me bazat, besimet dhe adhurimet që përmban Islami, do të nxitonin për ta përqaftuar atë grupe-grupe, siç ka ndodhur në fillim.”

³⁰ Shënon Muslimi.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”** (Es-Sebe, 28)

Imam Neveviu, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Thënia e Pejgamberit ﷺ ‘çdo njeri i këtij umeti..., që dëgjon për mua’ respektivisht që është i gjallë në kohën time dhe pas meje (vdekjes) e deri në Ditën e Kiametit, të gjithë e kanë për detyrë të më binden. I ka përmendur hebrenjtë dhe të krishterët dhe jo të tjerët, si tërheqje e vërejtjes, se atyre u është dhënë libër qiellor. Nëse kështu është puna me ata që u është dhënë libri, atëherë është më afërmendsh që ata, që nuk u është dhënë libri, ta kenë detyrë t’i përgjigjen dhe t’i binden atij.”³¹

³¹ *Sherhu en Nevevi ala Muslim.*

Veçoritë e Pejgamberit të zgjedhur

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Më janë dhënë pesë specifika, të cilat nuk i janë dhënë askujt para meje: 1. Allahu më ka bërë fitues në sajë të tmerrit, (duke i frikësuar armiqtë e mi) në largësi sa një muaj udhëtimi; 2. (tërë) toka më është bërë (mua dhe ithtarëve të mi) vend për falje dhe mjet pastrues (për tejemum), kështu që, kushdo nga pasuesit e mi mund të falet kudo që të jetë, në çdo kohë faljeje; 3. plaçka e luftës më është bërë hallall (e ligjshme), edhe pse një gjë e tillë nuk ka qenë e ligjshme për askënd para meje; 4. më është dhënë e drejta e ndërmjetësimit (në Ditën e Llogarisë); dhe 5. çdo pejgamber (para meje) dërgohej vetëm për popullin e tij, kurse unë jam dërguar për gjithë njerëzimin.”³²

Pejgamberi ynë është veçuar kundrejt të gjithë profetëve me specifika privilegjuese dhe lavdërime që nuk kanë qenë të njohura për të dërguarit para

³² Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

tij. Ky umet, me bekimin e këtij të Dërguari fisnik, arriti të fitonte disa nga vlerat vijuese:

E para: Allahu i Lartësuar e ndihmoi dhe i ofroi mbështetje kundër armiqve të tij duke i frikësuar, ndihmë prej Allahut dhe fitim për Pejgamberin e Tij, si dhe zhgënjim e dështim për armiqtë e fesë.

E dyta: Allahu i Lartësuar e mëshiroi të Dërguarin fisnik dhe umetin e tij duke ua bërë tërë tokën xhami. Kudo që i arrin namazi, mund të falen, ngase falja e namazit nuk kufizohet në vende të caktuara.

E treta: Plaçka e luftës që merret nga jobesimtarët dhe nga ata me të cilët luftohet është e lejuar dhe e ligjshme për Pejgamberin ﷺ dhe umetin e tij.

E katërta: Allahu i Lartësuar e veçoi Profetin e Tij me *mekamin mahmud* (pozitën e lartë) dhe ndërmjetësimin e madh ditën kur edhe të dërguarit e vendosur (*ulul azmi*) do të tërhiqen nga ky ndërmjetësim në sheshin e Kiametit, kurse Pejgamberi ynë do të thotë: “Unë jam (i autorizuar) për të.”

E pesta: Thirrja e çdo profeti të mëparshëm ishte vetëm për popullin e tij, ndërkaq, Profeti ynë është dërguar për tërë njerëzimin, thirrja e të cilit është gjithëpërfshirëse dhe shpëtim për mbarë njerëzit.

Udhëzimi i Pejgamberit ﷺ

Udhëzimi i tij ﷺ gjatë ngrënies

Ai ﷺ na porosiste që të hamë me të djathtën, ndërkohë ka ndaluar të hamë me të majtën. Ai thotë: *“Shejtani ha dhe pi me të majtën.”*³³

Ai nuk hante duke qenë i mbështetur. E, mbështetja ndahet në tri lloje: të mbështeturit në një anë, të ulurit këmbëkryq dhe të mbështeturit (e shpinës) në ndonjë objekt. Ai ﷺ transmetohet se ulej në gjunjë duke e vënë tabanin (pjesën e brendshme të) këmbës së majtë poshtë pjesës së jashtme të këmbës së djathtë, në shenjë modestie dhe edukate ndaj Zotit.

Ai porosiste që, ai i cili ha, të përmendte emrin e Zotit, ku thotë: *“Kur ndonjëri prej jush dëshiron të hajë ushqim, le ta përmendë emrin e Allahut para se të hajë (le të thotë “bismilah”). E, nëse harron ta përmendë emrin e Allahut në fillim të ushqimit,*

³³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

atëherë le të thotë: “Me emrin e Allahut, fund e krye.”³⁴

Udhëzimi i tij ﷺ gjatë pijes

Udhëzimi i tij kryesisht ka qenë të pijë ulur dhe ka ndaluar të pirët në këmbë. Megjithatë, njëherë ka pirë në këmbë, gjë për të cilën është thënë se ka pasur arsye të pranuar ose për shkak të shfuqizimit të ndalesës së mëparshme, si dhe është thënë për shkak të lejimit të dy çështjeve (edhe në këmbë, edhe ulur), gjë që është e sakta. Ndërsa pinte ujë, merrte frymë tri herë (e largonte enën nga goja dhe merrte frymë jashtë enës).³⁵

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Allahu është i kënaqur me robin e Tij që, kur ha ndonjë ushqim apo pi diç, e falënderon Atë.”

³⁴ Shënon Tirmidhiu.

³⁵ Lidhur me hollësi të tjera, shih librin *Zadul mead*, të Ibn Kajimit.

Dijetari i nderuar Muhamed ibn Salih el-Uthejmini, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Në këtë ka argument se kënaqja e Allahut të Lartësuar arrihet edhe me gjërat më të vogla. Pra, kënaqësia e Allahut mund të arrihet edhe me ndonjë vepër të vogël. Allahu kënaqet me njeriun që, kur të përfundojë të ngrënët, thotë *elhamdulillah* (falënderimi i takon vetëm Allahut), si dhe, kur të përfundojë të pirët, thotë *elhamdulillah*.”

Udhëzimi i Pejgamberit ﷺ para gjumit

Ibn Kajimi, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Pejgamberi ﷺ kur shkonte në shtrat, thoshte: “Me emrin Tënd, o Allah, jetoj e vdes.”³⁶ I bashkonte pëllëmbët e tij, pështynte (lehtas) në to dhe këndonte (suret): *Kul huvallahu ehad, Kul eudhu bi rabil felek, Kul eudhu bi rabin nas*. Më pas me pëllëmbët e tij përshkonte trupin sa më shumë që mundej, duke filluar me kokën, fytyrën e pjesët

³⁶ Shënon Buhariu.

e përparme të trupit. Kësisoj vepronte tri herë. Flinte në krahun e djathtë, dorën e djathtë e vinte nën faqen e djathtë, pastaj thoshte: *“O Allah, më ruaj nga dënimi Yt ditën kur i ringjall robërit e Tu!”* Gjithashtu, kur shkante në shtrat, thoshte: *“Falënderimi i takon Allahut që na ushqeje e na dha për të pirë, që na i përmbushi nevojat e na strehoi. Ndërkohë, save nuk u janë plotësuar nevojat dhe nuk kanë strehë.”*³⁷

Kur zgjohej nga gjumi

Kur zgjohej nga gjumi, Pejgamberi ﷺ thoshte: *“Falënderimi i takon Allahut, i Cili na ringjalli pasi na bëri të vdekur dhe tek Ai është tubimi.”*³⁸, më pas e përdorte misvakun, ndodhte edhe të këndonte dhjetë ajetet e fundit të sures *Ali Imran*, duke filluar nga fjala e Allahut të Lartësuar: **“Me të vërtetë, në**

³⁷ E ka përmendur Muslimi.

³⁸ Shënon Buhariu.

krijimin e qiejve dhe të Tokës...” e deri në fund të sures. (Ali Imran, 190-200)

Flinte në pjesën e parë të natës, kurse në pjesën e fundit falte namaz. E, kishte raste kur rrinte zgjuar në pjesën e parë të natës për interesat e muslimanëve. Sytë i vinte në gjumë, por zemra s’i flinte.³⁹

Udhëzimi i tij ﷺ gjatë selamit

Në dy koleksionet e sakta të haditheve është vërtetuar nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, të ketë thënë se Islami më i mirë dhe më i vlefshëm është të ushqesh (të varfrit) dhe të përshëndesësh me selam ata që i njeh e që s’i njeh.

Po ashtu, nga Ebu Hurejra, shënuar në *Sahihun* e Buhariut dhe në koleksione të tjera, është vërtetuar të ketë thënë se i vogli i jep selam të rriturit; ai që

³⁹ Për më tepër, referoju Zadul mead fi hedji hajril ibad, të Ibn Kajim el Xheuziut, 1/155-156.

ecën atij që është ulur; ai që është i hipur atij që ecën dhe grupi i vogël i jep selam grupit të madh.⁴⁰

**Udhëzimi i tij ﷺ për atë që hidhërohet tepër,
ç’duhet të thotë e të veprojë**

Atë që hidhërohet, e ka urdhëruar të marrë abdes, nëse është në këmbë, të ulet, e, nëse është i ulur, atëherë të mbështetet e të kërkojë mbrojtjen e Allahut të Lartësuar kundrejt djallit të mallkuar.⁴¹

⁴⁰ Zadul mead 2/406-412.

⁴¹ Për më tepër shih librin *Zadul mead fi hedji hajril ibad*, të Ibn Kajimit, *Allahu e mëshiroftë!*

Mos e shndërroni varrin tim në objekt adhurimi

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *“Mos i ktheni shtëpitë tuaja në varre e as mos e shndërroni varrin tim në vend feste, por më çoni selam, sepse selamet tuaja më arrijnë kudo që jeni.”*⁴²

Ibn Tejmije, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Në fjalët e Pejgamberit ﷺ ‘por më çoni selam, sepse selamet tuaja më arrijnë kudo që jeni’ nënkuptohet se, ai që çon përshëndetje dhe selame, arrijnë te Pejgamberi ﷺ qoftë afër apo larg varrit të tij, dhe nuk bën që varri i tij të shndërrohet në objekt adhurimi a vendfalje.”

Ali ibn Husejni, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon se kishte parë një njeri tek hynte përmes së çarës së varrit të Pejgamberit për t’u lutur, të cilin e kishte ndaluar duke i thënë: “A dëshironi t’ju tregoj një hadith që e kam dëgjuar nga babai im e ai nga gjyshi i tij? Pejgamberi ﷺ ka thënë:

⁴² Shënon Ebu Davudi.

“Mos e shndërroni varrin tim në vend feste e as mos i ktheni shtëpitë tuaja në varre, por më çoni selam, sepse selamet tuaja më arrijnë kudo që jeni.”⁴³

Ibn Uttejmini, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Mos bëni në varrin tim festë duke e nderuar me ardhjen tuaj çdo vit një a dy herë apo diç të kësisojtë. Këtu ka argument për ndalimin e marrjes së udhëtimit enkas me qëllim të vizitës së varrit të të Dërguarit ﷺ. Njeriu, edhe nëse dëshiron të shkojë në Medinë, nuk duhet të synojë që të udhëtojë me qëllim të vizituarit e varrit të Pejgamberit ﷺ, por të udhëtojë atje me qëllim të faljes së namazit në xhaminë e tij. Kur i çon selam Profetit ﷺ selami yt i arrin atij kudo qofsh ti, në tokë, në det, në ajër, afër apo larg tij.”⁴⁴

Ibn Uttejmini, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: “Hadithi argumenton se për njeriun është më e vlefshme që namazet vullnetare (*nafile*) t’i falë në shtëpi, bazuar

⁴³ *Fet’hul Mexhid sherhu Kitabi et teuhid*, f. 221-222.

⁴⁴ *Sherhu Rijadis salihin*, 3/573.

në hadithin e Pejgamberit ﷺ: *“Namazi më i mirë i një personi, përveç farzit, është namazi që e fal në shtëpi.”*⁴⁵

Fjala e tij ‘*por më çoni selam*’ është urdhër, respektivisht thoni: *Allahume sal-li ala Muhamed* (O Allah, zbritë bekimin Tënd ndaj Muhamedit). Allahu i Lartësuar ka urdhëruar një gjë të tillë duke thënë: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me “selam”!** (El Ahzab, 56)⁴⁶

⁴⁵ Shënon Buhariu.

⁴⁶ *El kaulul mufid ala kitabit teuhid*, 1/456-458.

Se ti je me virtyte madhore

Allahu i Lartësuar thotë: **“Se ti je me virtyte madhore.”** (El Kalem, 4)

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu më i sjellshëm.”⁴⁷

Ibn Uthejmini, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: “Sjellja e mirë manifestohet në raport me Allahun dhe robërit e Tij. Kështu, sjellja e mirë me Allahun nënkupton të qenët i kënaqur me vendimin dhe ligjin (rregullat) e Tij, si dhe pranimi i kësaj me zemërgjerësi, pa fyerje e pakënaqësi, pa pikëllim e pa hidhërim. Ndërkaq, me robërit e Allahut nënkupton mosshqetësimin (duke mos u bërë dëm e duke mos shqetësuar njerëzit, qoftë me gjuhë a me gjymtyrë), bujarinë (duke shpenzuar pasurinë, dijen, pozitën etj.) dhe t’i takosh fytyrëçelur (duke i

⁴⁷ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

takuar njerëzit fytyrëqeshur e jo fytyrëvrenjtur). Kjo është mirësjellja.⁴⁸

Hisham ibn Amiri tregon: “E takova Aishen dhe i thashë: “Oj nëna e besimtarëve! Më trego për moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ajo më tha: “Moralin e Allahut të Dërguarit të Allahut të Lartësuar: **“Se ti je me virtyte madhore.”**⁴⁹

Ibn Kethiri, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Kuptimi i kësaj është se ai, *alejhi salatu ue selam*, e ka zbatuar Kurandin në urdhrat dhe ndalesat e tij. Kjo i është bërë traditë, sjellje e fituar, duke lënë mënjanë të lindurën. Kështu që, ai zbatonte çdo gjë që urdhëron Kurani dhe linte çdo gjë që ai ndalon. Ja ç’i kishte dhuruar Allahu nga moralin: turpin, bujarinë, guximin, faljen e mirësinë, si dhe cilësi të tjera të bukura.”⁵⁰

⁴⁸ *Sherhu Rijadis salihin*, 2/430.

⁴⁹ *Musnedi i Ahmedit*.

⁵⁰ *Tefsiri i Ibn Kethirit*, 4/363.

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi ﷺ është pyetur për atë se ç’i fut njerëzit më së shumti në Xhenet, me ç’rast është përgjigjur: *“Devotshmëria dhe morali i mirë.”* Njëherazi është pyetur se çka i fut njerëzit më së shumti në Xhehenem? Ai u përgjigj: *“Gjuha dhe organi gjenital.”*⁵¹

Kërkimfalja e tij ﷺ

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Betohem në Allahun se unë i kërkoj falje dhe i drejtohem Allahut me pendim më se shtatëdhjetë herë në ditë!”*⁵²

Ibn Haxheri, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Fjalët e tij ‘*Betohem në Allahun se unë i kërkoj falje*’, janë betim rreth një çështjeje të konfirmuar, edhe pse nuk ekziston dyshimi tek ai që i dëgjon. Në fjalët ‘*unë i kërkoj falje dhe i drejtohem Allahut me*

⁵¹ Shënon Tirmidhiu, ndërsa Albani e klasifikon hasen.

⁵² Shënon Buhariu.

pendim' nënkuptohet se ai kërkonte falje dhe pendohej, por mund të nënkuptohet edhe vetë shprehja *'Më fal, o Allah!'* Ndërkaq, pjesa *'më se shtatëdhjetë herë'* mund të nënkuptohet hiperbolizimi, sikurse mund të nënkuptohet vetë numri.”⁵³

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Lum për atë që në regjistrin e tij ka shumë istigfar (kërkimfalje).”*⁵⁴

Gjithashtu, Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Tuba është një pemë në Xhenet, udhëtimi nën të cilën zgjat njëqind vjet. Rrobat e banorëve të Xhenetit nxirren pikërisht prej kupës (degës) së saj.”*⁵⁵

⁵³ *Fet'hul Bari sherhu Sahihil Buhari.*

⁵⁴ Shënon Ibn Maxhe, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

⁵⁵ Shënon Ahmedi, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty ‘Keutherin’

Allahu i Lartësuar thotë: **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty ‘Keutherin’ (shumë të mira) (Keuther, 1)**

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Kam parë një lumë në Xhenet, brigjet e të cilit ishin prej tendash me perla zgavër. Thashë: “Çfarë është ky (lumë), o Xhibril?” Më tha: “Ky është Keutheri që ta ka dhuruar Zoti.”⁵⁶*

Imam Taberiu, *Allahu e mëshiroftë!*, në *Tefsirin* e tij thotë: “Keuther është emri i lumit që i është dhuruar të Dërguarit të Allahut ﷺ në Xhenet. Allahu e ka përshkruar si diç me ‘shumë të mira’ ngase është dhunti madhështore.”

Imam Kurtubiu, *Allahu e mëshiroftë!*, në *Tefsirin* e tij thotë: “Tirmidhiu transmeton nga Ibn Omeri, i cili tregon: “Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Keutheri është lumë në Xhenet. Dy brigjet e tij janë nga ari, ndërsa rrjedha është nga perlat dhe rubinet. Toka e tij

⁵⁶ Shënon Tirmidhiu, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

është më erëzuese se misku, uji i tij është më i ëmbël se mjalti dhe më i bardhë se bora.”⁵⁷

Esh Shenkiti, *Allahu e mëshiroftë!*, në *Tefsirin* e tij, thotë: “Në *Sahihun* e Buhariut transmetohet nga Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, se Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Ndërsa isha duke ecur në Xhenet, hasa një lumë. Dy brigjet e të cilit ishin disa kupola perle të zbrazura. Pyeta: “Çfarë është kjo, o Xhibril?” Ai më tha: “Ky është Keutheri.” Gjithashtu, me zinxhir të njëjtë transmetuesish, përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, e cila ishte pyetur lidhur me fjalën e Allahut të Lartësuar: “**Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty ‘Keutherin’** është përgjigjur: “Keutheri është lumi në Xhenet që i është dhuruar Pejgamberit tuaj. Brigjet e tij janë tenda perlash në formë zgavre dhe enët e tij janë të panumërta sa dhe yjet.”

Po ashtu me këtë zinxhir transmetuesish përcillet nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të dytë!*, se

⁵⁷ Hadithi është hasen sahih.

lidhur me Keutherin ka thënë: “Është mirësi që Allahu ia ka dhënë Profetit.”

Es Sadi, *Allahu e mëshiroftë!*, në *Tefsirin* e tij thotë: “Allahu i Lartësuar i drejtohet të dërguarit të Tij, Muhamedit ﷺ duke ia kujtuar mirësitë: “Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty ‘Keutherin’”, respektivisht të kemi dhënë të mira e dhunti të shumta. E, një prej gjërave që Allahu i Lartësuar do t’ia japë Pejgamberit të Tij ﷺ në Ditën e Kiametit është edhe lumi që quhet Keuther dhe Haudi (pellgu). Gjatësia e Haudit është një muaj, gjerësia një muaj (ecje), uji i tij është më i bardhë sesa qumështi, më i ëmbël se mjalti, enët e tij janë sa numri i yjeve të qiellit për nga madhësia dhe ndriçimi i tyre. Ai që pi ujë në të, nuk ndien kurrë më etje.”

I çoni salat dhe selam Pejgamberit ﷺ

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Atij që më dërgon një salavat, Allahu ia dërgon dhjetë sosh, i fshihen dhjetë gabime dhe lartësohet dhjetë shkallë.”⁵⁸

Rastet kur preferohet të dërgohen salavate për

Pejgamberin ﷺ

1. Gjatë *teshehudit* (uljes së fundit) në namaz.
2. Para dhe pas lutjes.
3. Ditën dhe natën e xhumasë, bazuar në thënien e Pejgamberit ﷺ: “Shpeshtoni salavatet ndaj meje ditën dhe natën e xhumasë. Atij që më dërgon një salavat, Allahu ia dërgon dhjetë sosh.”⁵⁹

⁵⁸ Shënon Nesaiu, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

⁵⁹ Shënon Bejhekiu, ndërsa Albani e klasifikon hasen.

4. Kur përmendet emri i Pejgamberit ﷺ apo edhe kur të lexohet gjatë shkrimit. Për këtë kemi udhëzimin e Pejgamberit ﷺ që thotë: *“Është i ngratë ai njeri, në praninë e të cilit përmendet emri im e ai nuk më dërgon salavat.”*⁶⁰
5. Kur hyjmë në xhami dhe kur dalim nga ajo.
6. Pas marrjes së tekbrit të dytë në namazin e xhenazes.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij lutën për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam”!”** (Ahzab, 56)

⁶⁰ Shënon Tirmidhiu.

Disa forma të salavatit ndaj Pejgamberit

1. *Allahume sal-li ala Muhamed.*⁶¹ O Allah dërgo salavate (mirësi, nderime, mëshirë) mbi Muhamedin.
2. *Allahume sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema sal-lejte ala Ibrahim, in-neke hamidun mexhidun. Allahume barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema barekte ala Ibrahim, in-neke hamidun mexhidun!* O Allah, dërgo salavate (mirësi, nderime, mëshirë) mbi Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e Muhamedit, ashtu siç ke dërguar salavate mbi familjen dhe pasardhësit e Ibrahimit, sepse Ti je i Denji për të gjitha lavdërimet, më Madhështori në lavdi! O Allah, bekoje Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e Muhamedit, ashtu siç e ke bekuar familjen e pasardhësit e Ibrahimit, sepse Ti je i Denji

⁶¹ *Sherhu Rijadis salihin, 3/571.*

për të gjitha lavdërimet, më Madhështori në Lavdi!⁶²

3. *Allahume sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema sal-lejte ala ali Ibrahim, ue barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema barekte ala ali Ibrahim fil alemine inneke hamidun mexhid!*⁶³
4. Musa ibn Talha, përcjellë nga babai i tij, tregon se njëherë të Dërguarit të Allahut ﷺ i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Si të të dërgojmë salavate (lutje që Allahu të të bekojë)?” Ai tha: “Thoni: *“Allahume sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema sal-lejte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid. Ue barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema barekte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid!”*⁶⁴

⁶² Shënon Buhariu.

⁶³ Shënon Muslimi.

⁶⁴ Shënon Nesaiu. Për më tepër, shih: *Xhelaul efhami fis salati ala hajril enami*, të Ibn Kajimit.

Kënaqësia e syrit të Pejgamberit ﷺ

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Të dashura nga dynjaja më janë bërë gratë dhe aromat e këndshme, ndërsa dritë e syve të mi më është bërë namazi.”*⁶⁵

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Ju e dini se në raport me Allahun unë jam më i devotshmi, më i singerti dhe më i miri.”*⁶⁶

Hudhejfe, Allahu qoftë i kënaqur me të!, tregon: *“Një natë isha duke u falur pas Pejgamberit. Ai filloi të lexojë suren *El-Bekare*. Pasi lexoi 100 ajete, mendova se do të bjerë në ruku, por vazhdoi së lexuari. Atëherë mendova se do ta lexonte tërë suren. Kur e mbaroi suren, mendova se do të bjerë në ruku, mirëpo zuri të lexonte suren *En-Nisa* dhe më pas suren *Ali Imran*. Leximi i tij ishte (i një ritmi) normal, nuk ishte i shpejtë. Kur lexonte ndonjë ajet*

⁶⁵ Shënojnë Ahmedi dhe Nesaiu.

⁶⁶ Shënon Buhariu.

lavdërimi, e lavdëronte Allahun; kur lexonte ndonjë ajet lutjeje, lutej; si dhe, kur lexonte ndonjë ajet kërcënimi, i kërkonte Allahut ta mbrojë. Më pas ra në ruku dhe tha: *“Subhane Rabijel adhim.”* Ai e zgjati rukunë afërsisht aq sa kishte qëndruar në këmbë. Më pas tha: *“Semiallahu limen hamideh”,* u ngrit nga rukuja dhe qëndroi në këmbë afërsisht aq sa qëndroi në ruku. Më pas ra në sexhde dhe tha: *“Subhane Rabijel ala.”* Ai e zgjati sexhden afërsisht sa qëndrimi në këmbë.”⁶⁷

⁶⁷ Shënon Muslimi.

E si të mos jem rob falënderues

Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon se Pejgamberi ﷺ falej aq shumë natën, saqë i plasaritëshin këmbët. Ajo e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, përse vepron kësisoj, ndërkohë Allahu t’i ka falur të gjitha gabimet, ato që ke bërë dhe ato që do të bësh?!” Profeti iu përgjigj: *“E si të mos jem rob falënderues.”*⁶⁸

Dijetari Muhamed ibn Uthejmin, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: “Pejgamberi ﷺ falej natën dhe e zgjaste namazin derisa i plasaritëshin këmbët, saqë i rridhnin gjak, ndaj i ishte thënë: “Përse vepron kësisoj, ndërkohë Allahu t’i ka falur të gjitha mëkatet e mëparshme dhe të ardhshme? Ai qe përgjigjur: *“E si të mos jem rob falënderues.”*”

Këto vepra Pejgamberi ﷺ i bënte në shenjë falënderimi ndaj mirësive të Allahut të Lartësuar. Kjo tregon se falënderimi nënkupton bindjen ndaj Dhuruesit të mirësive përkatëse. Nëse njeriu thotë:

⁶⁸ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

‘Falënderimi i takon Allahut’, që është falënderim me gjuhë, nuk mjafton, por patjetër ky falënderim duhet dëshmuar me gjymtyrë, duke iu bindur Allahut të Lartësuar. Kjo dëshmon durimin dhe dashurinë e Profetit ﷺ ndaj namazit, ngase është e pamundur që dikush t’i bëjë ato punë vetëm nga dashuria e madhe. Prandaj ka thënë: “*Namazi më është bërë gëzim i syve të mi.*”⁶⁹ Namazi ka qenë vepra më e dashur e të Dërguarit, *alejhis-salatu ues-selam*.⁷⁰

Butësia e zemrës së Pejgamberit dhe qarja e tij nga frika ndaj Allahut

Abdullah ibn esh-Shihiri tregon: “Njëherë pata shkuar tek i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili po falte namaz dhe, ngaqë ngashërente, nga gjoksi i dilnin zhurma si kur zien kazani!”⁷¹

⁶⁹ Shënojnë Ahmedi dhe Nesaiu.

⁷⁰ *Sherhu Rijadis salihin*, 3/393-394.

⁷¹ Shënon Ebu Davudi, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

Litari i shpëtimit

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “... kapuni për Sunetin tim dhe sunetin e udhëheqësve (kalifëve) të drejtë e të udhëzuar, kapuni për të me dhëmballë dhe kini kujdes nga gjërat e shpikura sepse çdo risi është humbje.”⁷²

Dijetari Muhamed ibn Uthejmin, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: “Fjala e tij ‘kapuni për Sunetin tim’ nënkupton se Pejgamberi ﷺ na urdhëron që, kur të shohim mospajtime, t’i përmbahemi Sunetit të tij. Andaj, thënia e tij ‘kapuni për Sunetin tim’ nënkupton përmbajuni fuqishëm Sunetit tim.

E, Suneti i tij ﷺ është mënyra në të cilën ka jetuar (rruga të cilën e ka ndjekur), në çështjet e besimit, moralit, veprës, adhurimit etj. Pasojmë praktikën e tij dhe gjykohe mi sipas saj, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë**

⁷² Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, që ka thënë se ky hadith është hasen sahih.

besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre...” (En Nisa, 65)

Suneti i Pejgamberit ﷺ është rruga e shpëtimit për atë të cilit Allahu ia dëshiron shpëtimin e tij nga devijimet dhe risitë, që janë të përmendura në librat e dijetarëve.”⁷³

⁷³ *Sherhu Rijadis salihin, 1/505-506.*

Diç nga mjekësia e Pejgamberit ﷺ

Ilaçi

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Shërimi është në tri gjëra: në një lugë mjalti, në nxjerrjen e gjakut të keq me kupa dhe në kauterizimin (djegien e plagëve me hekur të nxehtë), por unë ua ndaloj pasuesve të mi kauterizimin.”*⁷⁴

Fara e zezë

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Fara e zezë shëron çdo sëmundje, përveç vdekjes.”*⁷⁵

Uji Zemzem

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Uji i Zemzemit është për atë (qëllim) që pihet.”*⁷⁶

⁷⁴ Shënon Buhariu.

⁷⁵ Shënon Buhariu.

⁷⁶ Shënon Ibn Maxhe, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

Uji

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Temperatura e lartë është prej shfryrjes së Xhehenemit, ndaj freskojeni atë me ujë.”*⁷⁷

Axhua (lloj hurme) e Medinës

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Atë që ha në mëngjes shtatë hurma arabe (axhua), atë ditë nuk e kap as magjia, as helmimi.”*⁷⁸

Dijetari i madh Ibn Baz, *Allahu e mëshiroftë!*, thotë: *“Shpresojmë që edhe me llojet e tjera të hurmave Allahu sjell dobi, ngase përbërja është e përafërt, ndonëse hurmat e Medinës shquhen në këtë aspekt, siç ka potencuar Pejgamberi ﷺ në mbrojtjen nga magjia dhe helmimi.”*

⁷⁷ Shënon Ibn Maxhe, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

⁷⁸ Shënon Muslimi.

Vaj ulliri

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Konsumoni vaj ulliri dhe lyhuni me të, sepse ai nxirret nga pema e bekuar.”*⁷⁹

Shërimi hyjnor

Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Vëre dorën në vendin që të dhemb dhe thuaj ‘Bismilah’ (3 herë) dhe pastaj thuaj (7 herë) ‘Eudhu bilahi ue kudretihi min sherri ma exhidu ue uhadhiru’ (Në emër të Allahut. Kërkoj mbrojtjen e Allahut me fuqinë e Tij nga e keqja e kësaj që ndiej dhe frikohem).”*⁸⁰

⁷⁹ Shënon Tirmidhiu, ndërsa Albani e klasifikon sahih.

⁸⁰ Shënon Muslimi.

Detyrat e çdo muslimani kundrejt Pejgamberit ﷺ

Detyrat e çdo muslimani ndaj Profetit ﷺ janë:

Ta besojë,

Ta dojë,

T'i bindet,

Ta pasojë,

Ta marrë për shëmbëlltëri,

Ta nderojë,

Të respektojë atë me të cilën është dërguar,

Të këshillojë për të,

Ta dojë familjen dhe shokët e tij,

Të dërgojë salavate për të.

Ta besojë

Besimi në të Dërguarin e Allahut ﷺ obligon besimin në Allahun, melekët, librat, të dërguarit, Ditën e Fundit, si dhe përcaktimin e Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: **“Prandaj besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kuranin), që ju kemi zbritur. Allahu e di mirë çdo gjë që bëni ju.”** (Et-Tegabun, 8) Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë: **“... prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!”** (El Araf, 158)

Ta dojë

Dashuria ndaj tij është obligim me Kuran e Sunet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju**

sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” (Et-Teube, 24)

Pejgamberi ﷺ thotë: *“(Beto hem) në Atë, në Dorë të të Cilit është shpirti im, se asnjëri prej jush nuk do të ketë besim (të plotë), derisa unë të jem për të më i dashur sesa babai e fëmija i tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë.”*⁸¹

Mënyra për të shprehur dashurinë ndaj Pejgamberit ﷺ shfaqet përmes:

- Dashurisë së asaj me të cilën është dërguar, dashurisë ndaj asaj për të cilën ka thirrur, si dhe ndihmesës së tij dhe fesë.
- Respektimit dhe vlerësimit kur të përmendet ai dhe virtytet e tij.

⁸¹ Shënon Buhariu.

T'i bindet

Bindja ndaj Pejgamberit ﷺ është obligim me urdhrin e Allahut të Lartësuar: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!”** (Muhamed, 33)

Bindja nënkupton kryerjen e asaj që ka urdhëruar ai dhe largimin nga ajo që ka ndaluar, qoftë besim, fjalë a vepër.

Mënyra për të shprehur bindjen ndaj Pejgamberit ﷺ shfaqet përmes:

- Të punuarit dhe të udhëzuarit në përputhje me Sunetin dhe udhëzimin e tij.
- Sjelljes së mirë, uljes së zërit, pastërtisë së jashtme e të brendshme, sinqeritetit në fjalë e vepër.
- Të kërkuarit e hallallit në ushqim, pije, veshje dhe martesë.
- Dashurisë ndaj të gjorëve, duke u bërë mirë; vizitimit të varreve për të kërkuar

mëshirë dhe falje për ta, si dhe për të kujtuar gjendjen në të cilën ndodhen.

- Të vepruarit sipas parimit: **“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.”** (Hashr, 7)

Ta pasojë

Format e pasimit të të Dërguarit ﷺ shfaqen:

- Kur muslimani nuk sajon asnjë risi në fe.
- Kur kundërshtohet çdo thënie tjetër për hir të thënies së tij, kur lihet çdo ligj tjetër për ligjin e tij, si dhe kur shmanget nga çdo gjë që kundërshton udhëzimin e tij.
- Kur të punuarit bëhet në përputhje me Sunetin, pa marrë parasysh a është sunet obligues apo thjesht i preferuar.

Ta marrë atë si shëmbëlltyrë

Ne, muslimanët, jemi të urdhëruar ta marrim si model Pejgamberin ﷺ. Allahu i Lartësuar thotë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm.”** (El-Ahzab, 21)

Ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thotë: “Përmbajtja në ndonjë vepër që konsiderohet Sunet është më e mirë sesa përpjekja e madhe për një vepër që konsiderohet risi.”

Ta nderojë Profetin ﷺ

Vërtet, nderimi i Pejgamberit ﷺ është obligim i vërtetuar. Allahu i Lartësuar ka urdhëruar respektimin e Pejgamberit të Tij me fjalët: **“Që t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lavdëroni Atë (Allahun) me namaz në mëngjes dhe mbrëmje.”** (El-Fet’h, 9)

Domethënia e nderimit të tij:

Nderimi i Pejgamberit ﷺ nënkupton respektimin, madhërimin dhe lartësimin e tij.

Të këshillojë për të ﷺ

Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur janë të sinqertë e të përkushtuar ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, pra për të mirët nuk ka rrugë qortimi. Allahu fal shumë, është mëshirues.”** (Et-Teube, 91)

Ndërkaq, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Feja është këshillë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”*⁸²

Këshilla bëhet përmes:

- Vërtetimit të profetësisë së tij, që rezulton bindjen ndaj tij ﷺ.
- Dashurisë ndaj tij dhe familjes së tij.

⁸² Shënon Buhariu.

- Komunikimit të mesazhit të tij pas vdekjes, përhapjes së thirrjes dhe zbatimit të ligjit të tij.⁸³

⁸³ Shejh Ebu Bekër Xhabir el Xhezairi, *Hadhel habibu Muhamed ﷺ ja muhibu*, f. 437-447.

Disa mrekulli të Pejgamberit ﷺ

Çarja e Hënës

Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi shënojnë në përmbledhjet e tyre të haditheve se banorët e Mekës i kërkuan të Dërguarit të Allahut ﷺ që t'u shfaqte ndonjë mrekulli, me ç'rast ai i bëri të shohin Hënën tek çahëj në dy pjesë. Mutimi thotë: "Në kohën e të Dërguarit të Allahut ﷺ u nda Hëna në dy pjesë. Njëra pjesë shkoi në drejtim të kodrës e ata thanë: "Muhamedi na bëri magji!" Në vërtetim të kësaj Allahu i Lartësuar shpalli ajetet: **"U afrua Ora dhe u ça Hëna! E megjithatë, sa herë që shohin ndonjë mrekulli, ata kthejnë kurrizin dhe thonë: "Kjo është në vazhdën e magjive të tij!" Ata e mohojnë (të vërtetën) dhe pasojnë dëshirat dhe tekat e tyre, por çdo gjë është e caktuar."** (El-Kamer, 1-3)

Rrjedhja e ujit midis gishtave të tij

Ahmedi dhe Buhariu shënojnë nga Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, shërbëtori i të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili tregon: “Tek shoqërohesha me Pejgamberin, ishte afruar koha e namazit të ikindisë, gjë për të cilën njerëzit kërkonin ujë, por nuk gjenin. Profetit i sollën një enë me ujë, ku futi dorën, sakaq uji filloi të rrjedhë midis gishtërinjve të tij! Kështu, të gjithë njerëzit morën abdes me atë ujë.” Katade thotë: “E pyeta Enesin: “Sa vetë keni qenë?” Enesi m’u përgjigj: “Diku treqind.”

Guri i jep selam Pejgamberit ﷺ

Pejgamberi ﷺ thotë: “Njoh në Mekë një gur që, para se të bëhesha profet, më jepte selam. Ende e njoh mirë atë!”⁸⁴

⁸⁴ Shënon Muslimi.

E, dhënia selam nga guri, që është i pajetë, konsiderohet çështje e jashtëzakonshme, përkatësisht muxhize (mrekulli).⁸⁵

Bukuria e krijimit të tij

Më të mirë se ti s'kanë parë kurrë sytë e mi. Fëmijë më të bukur se ti s'lind asnjë nënë.

El Bera, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pejgamberi ﷺ ka qenë njeriu me pamjen më të bukur dhe me moralin më të mirë. Beraun e pyetën: “A ka qenë fytyra e Pejgamberit (e shndritshme) si shpata?” Ai u tha: “Jo, porsi Hëna.”

Xhabir ibn Seleme, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “E kam parë (Profetin ﷺ) në natën me hënë të plotë. E shikoja herë Pejgamberin ﷺ, herë Hënë. I Dërguari i Allahut ﷺ ishte në kaftan të

⁸⁵ Shejh Ebu Bekër Xhabir el Xhezairi, *Hadhal habibu Muhamed, sal-lallahu alejhi ue selem, ja muhibu*, f. 392-400.

kuq. Pata ardhur në përfundimin se për mua ai është më i bukur se Hëna.”

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Kurrë në jetën time nuk kam parë diç më të bukur se Pejgamberi ﷺ. Dukej sikurse dielli lundronte në fytyrën e tij. Nuk kam parë askënd që mund të ecte më shpejt se ai. Dukej sikur toka shpejtonte poshtë tij, ne lodheshim për ta arritur, ndërsa ai ishte i palodhshëm.”

Kab ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Kur gëzohej, fytyra i shndriste sikur të ishte një copë hëne.”

Ndërkaq, Ebu Bekri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, kur e shihte, thoshte:

“I zgjedhuri (Mustafai) thërret në mirësi, zhduk errësirën si drita hënëplotë.”

Omer ibn Hatabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, lidhur me bukurinë e Pejgamberit të Allahut ﷺ citonte vargjet e Zuhejrit, i cili e përshkruante Herim ibn Sinanin:

“Po të mos ishe qenie njerëzore, do të ishe dritë në natën hënëplotë.”

Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Dhëmbët e përparmë i ka pasur të ndarë (nga njëri-tjetri). Kur fliste, dhëmbët mes buzëve i shkëlqenin sikurse varg margaritarësh.”

Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Nuk kam prekur mëndafsh e as kadife më të butë se dora e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe nuk kam nuhatur erë më të mirë sesa amësimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ.” Në motërzimin tjetër qëndron: “As amberi, as misku nuk erëmojnë më këndshëm sesa lëkura e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue sel-lem.*”

Ebu Xhuhejfa, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Ia mora dorën dhe e vura në fytyrën time. Vura re se ajo ishte më e ftohtë se akulli dhe me erë më të këndshme sesa misku.”

Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, tregon: “Pikat e djersës u ngjanin margaritarëve.”

Ndërkaq, Umu Seleme, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thotë: “Erëmonte më këndshëm se çdo aromë tjetër.”⁸⁶

Vargjet e Hasan ibn Thabitit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*:

Vula e bardhë mes shpatullash i duket dukshëm dhe qartë profetësinë ia fakton,

Emrin e Vet me të Profetit e bashkoi, gjë që myezini pesë herë në ditë e shqipton.

Për ta nderuar, Pronari i Arshit, prej emrit Mahmud⁸⁷ ia dha emrin Muhamed,

I Dërguari erdhi kur idhujt adhuroheshin e qemë shpresëprerë pas periudhës pa profet,

Pas tërë kësaj, në Tokë ai ndriçoi e udhëzoi ashtu siç shkëlqen shpata e mprehtë.

⁸⁶ Safijurrahman el Mubarekfuri, *Er Rahikul mehtum*, f. 459-461.

⁸⁷ Është fjala për Allahun që ka epitelin El-Mahmud (i Lavdëruari), prej nga rrjedh emri Muhamed.

*Na the larg Xhehenemit e myzhde Xhenetin, Islamin
na mësove, ndaj Allahun e falënderojmë,*

*O Allah, Ti je Krijuesi i gjithçkaje, Zoti ynë, prandaj
përherë këtë e dëshmojmë.*

*I Patëmeta je dhe larg atij që tjetërkënd pos Teje
adhuron, o më i Lartësuari,*

*O Allah, ty të takon çdo mirësi, prandaj për ne
vetëm Ti je i Adhuruari.*

*Në djepin e moçëm, në Medinën e të Dërguarit,
përherë drita rrezatonte,*

*Tek është dhoma ku i zgjedhuri jetonte me nurin e
Allahut dhe shpalljen e pranonte.*

*Ndihmoje Profetin, se Allahu e ka graduar kundrejt
të tjerëve me devotshmëri e bujari,*

*Në ne jeton i Dërguari i Allahut, që duhet ndjekur e
ndihmuar deri në vdekje, pa kufi.*

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Parathënie | 5 |
| Dëshmia se Muhamedi ﷺ është i dërguari i Allahut . | 7 |
| Emrat e tij ﷺ | 11 |
| Profeti i fundit ﷺ | 11 |
| Unë jam Pejgamberi pa asnjë gënjeshtër | 12 |
| Ndiqe Profetin e mos fut risi në fe | 14 |
| Mëshirë për botët..... | 15 |
| Modele nga mëshira e tij ﷺ | 16 |
| Mëshira e tij ndaj armiqve..... | 17 |
| Mëshira e tij ndaj kafshëve..... | 17 |
| Mëshira e tij ndaj fëmijëve | 19 |
| Mëshira e tij ndaj shërbëtorëve dhe robërve..... | 20 |
| Sjellja e tij me familjen | 21 |
| Sjellja e tij me fëmijët dhe të rinjtë | 22 |
| Të qeshurit e tij ﷺ | 23 |
| Modestia e tij ﷺ | 24 |
| Universaliteti i mesazhit të zotërisë së krijesave ﷺ . | 27 |
| Veçoritë e Pejgamberit të zgjedhur | 29 |
| Udhëzimi i Pejgamberit ﷺ | 32 |
| Udhëzimi i tij ﷺ gjatë ngrënies | 32 |
| Udhëzimi i tij ﷺ gjatë pijes | 33 |
| Udhëzimi i Pejgamberit ﷺ para gjumit..... | 34 |
| Kur zgjohej nga gjumi | 35 |
| Udhëzimi i tij ﷺ gjatë selamit | 36 |
| Udhëzimi i tij ﷺ për atë që hidhërohet tepër, ç’duhet të thotë e të veprojë..... | 37 |

| | |
|---|----|
| Mos e shndërroni varrin tim në objekt adhurimi | 38 |
| Se ti je me virtyte madhore | 41 |
| Kërkimfalja e tij ﷺ | 43 |
| Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty 'Keutherin' .. | 45 |
| I çoni salat dhe selam Pejgamberit ﷺ | 48 |
| Rastet kur preferohet të dërgohen salavate për Pejgamberin ﷺ | 48 |
| Kënaqësia e syrit të Pejgamberit ﷺ | 52 |
| E si të mos jem rob falënderues | 54 |
| Butësia e zemrës së Pejgamberit dhe qarja e tij nga frika ndaj Allahut | 55 |
| Litari i shpëtimit | 56 |
| Diç nga mjekësia e Pejgamberit ﷺ | 58 |
| Ilaçi | 58 |
| Fara e zezë | 58 |
| Uji Zemzem | 58 |
| Uji | 59 |
| Axhua (lloj hurme) e Medinës | 59 |
| Vaj ulliri | 60 |
| Shërimi hyjnor | 60 |
| Detyrat e çdo muslimani kundrejt Pejgamberit ﷺ .. | 61 |
| Disa mrekulli të Pejgamberit ﷺ | 69 |
| Çarja e Hënës | 69 |
| Rrjedhja e ujit midis gishtave të tij | 70 |
| Guri i jep selam Pejgamberit ﷺ | 70 |
| Bukuria e krijimit të tij | 71 |